



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 290/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2018 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Eglenti” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me objekt “*Blerje produkte te ndryshme*” me nr. REF-53224-03-01-2018 me fond limit 957,760 lekë (pa TVSH) zhvilluar në datën 12.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Sociale Multidisiplinare.

Ankimues:

“Eglenti” sh.p.k.

Adresa: Rr “ Pjetër Budi” Nd.29 H.3. Ap.14, Njësia administrative nr.2,1010

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Sociale Multidisiplinare

*Adresa: Rruga “Maliq Muco”, Nr.19
Tiranë*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.03.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në Sistemin e prokurimeve Elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e “*Kërkesë për Propozime*” me objekt “*Blerje produkte te ndryshme*” me nr. REF-53224-03-01-2018 me fond limit 957,760 lekë (pa TVSH) zhvilluar në datën 12.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Sociale Multidisiplinare.

II.2. Në datën 12.03.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 13.03.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Eglenti” shpk	906,495 lekë	skualifikuar;
2. “Nika” shpk	920,462 lekë	kualifikuar

II.4 Operatori ekonomik “Eglenti” sh.p.k. është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: “*Në shtojcën 8 te DST , pika 3 kriteret teknike, gërma a :është kërkuar licence*

profesionale kategoria II.1.A. Nga ana juaj është paraqitur licence për kategorinë II.1.B, për këtë arsye skualifikohen”

II.5. Në datën 19.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se [...] *KVO e institucionit që ju drejtonit ka skualifikuar shoqërinë “Eglenti” shpk me pretendimin se nuk ka paraqitur licencën profesionale, kategoria II.1.A të kërkuar në DST por licencën profesionale II.1.B. Në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “Eglenti” shpk në faqen zyrtare të APP-së për këtë procedurë prokurimi ndër të tjera është paraqitur edhe licenca profesionale II.1.A me nr. PN 9813-04-25, LN 663-07-2013 shoqëruar me kontratat e furnizimit respektive me operatorë të licencuar, të cilët jo vetëm përmbushin katërcipërisht kriterin e kërkuar nga ju në DST por gjithashtu garantojnë më së miri realizimin e objektit të kontratës. Shoqëria “Eglenti” shpk ka paraqitur kontratën e furnizimit noteriale me nr. 320 rep nr.123 kol datë 12.02.2012 me personin fizik Qamil Xhelili me objekt veprimtarie “Furrë buke” licencuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me QKL përkatëse, PN -9813-04-2015, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Leje mjedisi e tipit C për aktivitetin: Furra të prodhimit të bukës” me kod II.1.A. Theksojmë se kjo Licencë përmbush më së miri plotësimin e objektit të kontratës për furnizimin e institucionit tuaj me sanduice pjesë e preventivit të kërkuar nga ana juaj. Shoqëria “Eglenti” shpk ka paraqitur kontratën e furnizimit datë 10.01.2018 me shoqërinë “Lara Daisy” shpk e cila zotëron nën pronësinë e saj Fabrikë për Grumbullimin, përpunimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij”, licencuar nga Ministria e Ushqimit, Mbrotjes së Konsumatorit me QKL-në përkatëse LN 663-07-2013 me emërtim përshkrues të veprimtarisë: “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e qumështit dhe nënprodukteve të tij” me kod II.1.A. Theksojmë se kjo licencë përmbush më së miri plotësimin e objektit të kontratës për furnizimin e institucionit tuaj me qumësht, pjesë e preventivit të kërkuar nga ana juaj. Theksojmë gjithashtu se në preventivin e dhënë në DST janë kërkuar vetëm ujë-qumësht, biskota, sanudic. Nga këto artikuj për dy prej tyre konkretisht qumësht dhe sanduic për të cilat është kërkuar licenca profesionale II.1.A kemi paraqitur licencat respektive të cilat përmbushin kriterin e kërkuar në DST. Ajo që nuk arrijme të kuptojmë është se si anëtarët e KVO-së nuk njohin si të ligjshme një kontratë furnizimi e cila vërteton mundësitë e operatorit ekonomik pjesëmarrës për realizimin e objektit të kontratës dhe u dashka domsdoshmërisht që këto ambjente të jenë në pronësi të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë. Sa më lart kërkojmë rikuotimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë dhe kualifikimin e shoqërisë “Eglenti” shpk si oferta më e leverdisshme për ju në të kundërt do ti drejtohem organeve kompetente për fitimin e të drejtës tonë. [...]*

II.7. Në datën 20.03.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 39/1 prot. Datë 20.03.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, mos pranuar ankesën.

II.8. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “ *Në lidhje me pretendimin se ju keni paraqitur kontratë furnizimi noteriale me nr.320 rep dhe nr.123 kol datë 12.02.2018 me personin fizik Qamil Xhelili me objekt veprimtarie “Furrë Buke” me emërtim përshkrim veprimtarie “Leje e mjedisit e tipit C” për aktivitetin “Furra të prodhimit të bukës është e pabazuar në shtojcën 8, Kriteret e Veçanta, pika 3 kapaciteti teknik, gërma “a” kërkohet “ Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale, kategoria*

II.1.A lëshuar nga organet kompetente QKL” pasi ju dispononi leje me kategori për mjedis të tipit C e cila nuk është përputhje me kategorinë e kërkuar nga AK. Përsa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron. Në lidhje me pretendimin e dytë se keni paraqitur kontratë furnizimi datë 10.01.2018 me shoqërinë Lara Daisy shpk e cila zotëron në pronësinë e saj fabrikë për grumbullimin dhe përpunimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij. Lara Daisy shpk disponon licencën profesionale me kategorinë II.1.A. Pretendimi i këtij operatori nuk qëndron pasi: Në dokumentat standarde të tenderit në fund të shtojcës 8 kërkohet “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta konsiderohen si kushte për skualifikim” Ju keni paraqitur kontratë bashkëpunimi midis OE Eglanti shpk dhe Lara Daisy shpk me një afat të pa përcaktuar. Duke ju referuar DST, kjo kontratë nuk është e njëjsuar (noterizuar) pranë organeve kompetente. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron.[...]”

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 45 prot., datë 05.04.2018, të protokolluar me tonën në datën 06.04.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Eglenti” sh.p.k. për kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij me argumentet se: “KVO e institucionit që ju drejtonit ka skualifikuar shoqërinë “Eglenti” shpk me pretendimin se nuk ka paraqitur licencën profesionale, kategoria II.1.A të kërkuar në DST por licencën profesionale II.1.B. Në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “Eglenti” shpk në faqen zyrtare të APP-së për këtë procedurë prokurimi ndër të tjera është paraqitur edhe licenca profesionale II.1.A me nr. PN 9813-04-25, LN 663-07-2013 shoqëruar me kontratat e furnizimit respektive me operatorë të licencuar, të cilët jo vetëm përmbushin katërcipërisht kriterin e kërkuar nga ju në DST por gjithashtu garantojnë më së miri realizimin e objektit të kontratës. Shoqëria “Eglenti” shpk ka paraqitur kontratën e furnizimit noteriale me nr. 320 rep nr.123 kol datë 12.02.2012 me personin fizik Qamil Xhelili me objekt veprimtarie “Furrë buke” licencuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me QKL përkatëse, PN -9813-04-2015, me emërtim përshkruese të veprimtarisë “Leje mjedisi e tipit C për aktivitetin: Furra të prodhimit të bukës” me kod II.1.A. Shoqëria “Eglenti” shpk ka paraqitur kontratën e furnizimit datë 10.01.2018 me shoqërinë “Lara Daisy” shpk e cila zotëron nën pronësinë e saj Fabrikë për Grumbullimin, përpunimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij”, licencuar nga Ministria e Ushqimit, Mbrotjes së Konsumatorit me QKL-në përkatëse LN 663-07-2013 me emërtim

përshkrues të veprimtarisë: “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e qumështit dhe nënprodukteve të tij” me kod II.1.A.” Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, gërma “a”, është përcaktuar: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën profesionale, kategoria II.1.A lëshuar nga organet kompetente, QKL”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si edhe parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, në përmbushje të kriterit të mësipërm është dorëzuar:

- i. Licencë Kodi II.1.B nr. LN-6160-02-2013 lëshuar për subjektin “Eglenti” shpk me emërtim përshkrues të veprimtarisë “ Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (mishi dhe nënproduktet e tij);
- ii. Licencë Kodi II.1.B nr. LN-6161-02-2013 lëshuar për subjektin “Eglenti” shpk me emërtim përshkrues të veprimtarisë “ Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (bulmet dhe nënproduktet e tij vezë);
- iii. Kontratë furnizimi lidhur mes shoqërisë “Eglenti” shpk dhe “Qamil Xhelili” p.f. me objekt *“furnizimi me bukë i të gjitha llojeve”* shoqëruar me licencë kodi II.1.A. nr PN-9813-04-2015 me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Leje mjedisore e tipit C për aktivitetin “Furrë të prodhimit të bukës” lëshuar për subjektin “Qamil Xhelili”. P.f. ;
- iv. Kontratë bashkëpunimi lidhur mes shoqërisë “Eglenti” shpk dhe “Lara Dairy” shpk me objekt *“furnizimi me qumësht dhe nënprodukteve të tij”* shoqëruar me licencë kodi II.1.A. me nr. LN-663-07-2013 me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Leje mjedisore e tipit C për aktivitetin “Prodhim përpunim e shpërndarje me shumicë e qumështit dhe nënprodukteve të tij” lëshuar për subjektin “Lara Dairy”. shpk

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”;*

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit mbi dorëzimin e licencës profesionale, kategoria II.1.A lëshuar nga organet kompetente, QKL në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar Licencë Kodi II.1.B nr. LN-6160-02-2013 lëshuar për subjektin “Eglenti” shpk me emërtim përshkrues të veprimtarisë “ Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për

njerëz (mishi dhe nënproduktet e tij) dhe Licencë Kodi II.1.B nr. LN-6161-02-2013 lëshuar për subjektin “Eglenti” shpk me emërtim përshkrues të veprimtarisë “ Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz (bulmet dhe nënproduktet e tij vezë). Dy licencat e mësipërme, megjithëse janë lëshuar për vetë operatorin ekonomik ankimes, KPP konstaton se ato nuk përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktor pasi i përkasin kategorisë II.1 nënkategoria “B”, ndërkohë nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar disponueshmëria e licencës lëshuar nga QKL e kategorisë II.1, por e nënkategorisë “A”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ndodhemi para dy nënkategorive të ndryshme të licencave të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor krahasuar me atë të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes. KPP nënvizon faktin se ndër parimet kryesore të zhvillimit dhe përzgjedhjes është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

III.1.6. Referuar parashtrimeve me shkrim të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes para autoritetit kontraktor dhe para Komisionit të Prokurimit Publik, KPP konstaton se ndër të tjera, ankimesi ka pretenduar se kriterin e mësipërm të kualifikimit e përmbush me anë të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me shoqëritë “Lara Dairy”. shpk dhe “Qamil Xhelili” p.f. për të cilët ka dorëzuar kontratat respektive të furnizimit. Referuar sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankimesi është tërësisht në kushtet e mospërmbushjes së kriterit në lidhje me Licencën e kategorisë II.1.A. KPP nënvizon faktin se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Referuar *lex specialis* përmbushja e kriterëve për kualifikim i shtrin efektet mbi operatorët ekonomikë pjesëmarrës ose grupe operatorësh ekonomikë. Në rastin konkret operator ekonomik pjesëmarrës është shoqëria “Eglenti” shpk dhe dokumentacioni i dorëzuar në lidhje me shoqëritë “Lara Dairy”. shpk dhe “Qamil Xhelili” p.f. të cilët nga verifikimi i kryer në SPE nuk rezultojnë në cilësinë e anëtarit të bashkimit të operatorëve ekonomikë me shoqërinë “Eglenti” shpk, nuk mund të përmbushë kriteret e veçanta të kualifikimit.

III.1.6. Sqarojmë se nëse ankimesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar*

plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik “Eglenti” sh.p.k. nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eglenti” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me objekt “Blerje produkte te ndryshme” me nr. REF-53224-03-01-2018 me fond limit 957,760 lekë (pa TVSH) zhvilluar në datën 12.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Qendra Sociale Multidisiplinare.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 638 Protokolli

Datë 29.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha